



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përfitimi i kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë Digital Charging Solution GmbH (JV), nëpërmjet blerjes së aksioneve nga shoqëria BP Europa SE.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.224 Prot., i AK, datë 28.04.2021 “Përqendrimi ndërmjet BP Europa SE dhe Bayerische Motoren Werke Aktiengesellschaft, Daimler AG/ Digital Charging Solution GmbH”- Njoftim në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës.”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e blerjes së aksioneve nga shoqëria BP Europa SE në shoqërinë Digital Charging Solution GmbH(JV).

Palët në marrëveshje janë:

BP Europa SE, një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionin gjerman, me objekt veprimtarie; nxjerrja, përfitimi, përpunimi, magazinimi, transporti dhe shpërndarja e gazit, naftës së përpunuar, gazit natyror dhe mineraleve të tjera, etj.

BP është prezente në Shqipëri përmes AIR BP Albania, aktive në fushën e tregtimit me shumicë të lëndëve djegëse për mjetet e fluturimit ajror reaktiv, karburanteve për avionë dhe mjeteve motorike si dhe cdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme për shoqërinë .

Digital Charging Solutions GmbH, një ndërmarrje e përbashkët me funksione të plota (joint-venture), e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me aktivitet zhvillimi, tregtimi dhe shitja e produkteve dhe shërbimeve në fushën e lëvizjes, në veçanti ofrimi i shërbimeve të informacionit dhe teknologjisë së hyrjes në infrastrukturën e tarifimit për automjetet elektrike dhe hibride, shitja dhe blerja e energjisë elektrike në pikat e karikimit për automjetet elektrike dhe hibride si dhe shërbime për funksionimin e një rrjeti të stacioneve të karikimit për automjete elektrike dhe hibride.

BMW Intec Beteiligungs GmbH është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit gjerman, e zotëruar në mënyrë direkte nga BMW, me aktivitet kryesor prodhimin e makinave të pasagjerëve dhe motoçikletave në të gjithë botën si dhe ofrimin e shërbimeve premium në fushën e lëvizjeve individuale.

Daimler Mobility Services GmbH, është një filial i kontrolluar në mënyrë indirekte nga Daimler AG, me aktivitet në fushën e zhvillimit, prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve dhe ofrimit të shërbimeve të automjeteve, motorëve dhe drejtuesve teknikë të të gjitha llojeve; teknologjisë së informacionit; shërbimeve të lëvizjes dhe transportit etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.